

V E N D I M
Nr.314, datë 30.4.1996

PËR PËRCAKTIMIN E PËRFAQËSUESHMËRISË NË NJËSINË E BISEDIMIT

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kanë të drejtë të kërkojnë hapjen e bisedimeve lidhur me përfundimin e kontratës kolektive të punës çdo organizatë punëmarrësish e krijuar në bazë të ligjit, si dhe punëdhënës apo organizatë punëdhënësish.

2. Kur disa sindikata nuk arrijnë të bien dakord për të qenë palë së bashku si përfaqësues të punëmarrësve në kontratën kolektive të punës, atëherë vetëm sindikata apo grupi i sindikatave më të përfaqësuar në njësinë e bisedimit kanë të drejtën ekskluzive për të biseduar dhe përfunduar kontratën kolektive të punës.

3. Konsiderohen si tregues të nevojshëm mbi përfaqësueshmërinë e organizatës apo organizatave të punëmarrësve shifrat që tregojnë numrin total të punëmarrësve në njësinë e bisedimit dhe, në funksion të këtij numri, atë të punëmarrësve të përfaqësuar nga kjo apo nga këto organizata.

4. Kur përfaqësueshmëria e sindikatës apo e sindikatave është kundërshtuar, ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë përcakton njësinë e bisedimit. Njësia e bisedimit përcaktohet kryesisht në funksion të kërkesës së sindikatës apo të sindikatave kërkuese të bisedimeve.

Ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë mund të vendosë, në rastin kur bisedimet i interesojnë një dege të tërë të ekonomisë, një njësi bisedimi më të gjerë, nëse ai gjykon se në të njëjtën degë të ekonomisë ekziston një sindikatë tjetër, e cila pretendon se është përfaqësuese.

5. Votimi i fshehtë ka për objekt të përcaktojë përfaqësueshmërinë e sindikatave të interesuara në njësinë e bisedimit.

Mund të marrin pjesë në të vetëm punëmarrësit e punësuar në njësinë e bisedimit.

Kur në një pjesë të njësive së bisedimit përqindjet e përfaqësueshmërisë së sindikatave nuk janë kundërshtuar, ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë ka të drejtë të heqë dorë nga organizimi i votimit të fshehtë në këtë pjesë.

6. Votimi zhvillohet të shumtën një muaj pas vendimit të ministrit mbi përcaktimin e njësive së bisedimit.

7. Një komision votimi, i cili do të organizojë votimin dhe do të kujdeset për mbarëvajtjen e tij, duhet të ngrihet të paktën 20 ditë para datës së votimit.

Komisioni i votimit përbëhet nga kryetari, që është drejtor i zyrës lokale të punës, nga specialisti i marrëdhënieve profesionale pranë kësaj zyre, nga një përfaqësues i punëdhënësit dhe nga përfaqësuesit e sindikatave që marrin pjesë në votim.

Kur sindikatat nuk bien dakord për përfaqësuesit e tyre, atëherë ata caktohen nga drejtori i zyrës lokale të punës, ose në rast se njësia e bisedimit e tejkalon kuadrin e kompetencës territoriale të një zyre lokale pajtimi, nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

8. Listat emërore të punëmarrësve të përfshirë në njësinë e bisedimit duhet të përgatiten dhe të dorëzohen nga punëdhënësi apo punëdhënësit në komisionin e votimit të paktën 15 ditë para datës së votimit.

9. Çdo sindikatë që pretendon të drejtën e përfaqësimit të punëmarrësve në njësinë e bisedimit pajiset me një numër, i cili hidhet me short nga kryetari i komisionit të votimit.

Kur disa sindikata formojnë një grup dhe pretendojnë këtë të drejtë së bashku, atëherë atyre i caktohet një numër i vetëm.

Fletëvotimet duhet të shtyhen nga zyra lokale e punës, në bazë të një modeli të parapërgatitur nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

Shtypja dhe dërgimi i fletëvotimeve do të mbikëqyren nga komisioni i votimit. Komisioni duhet të kujdeset që të gjitha fletëvotimet e parashikuara për votimin të ndodhen në lokalin e votimit ditën e duhur.

Para hapjes së votimit komisioni kontrollon kutinë e votimit dhe bën mbylljen me vulë të saj.

10. Komisioni i votimit duhet të përshtatë lokalin e votimit në mënyrë të tillë që të sigurohen pavarësia e punëmarrësit që voton, lehtësia dhe fshehtësia e votës.

Rendin në lokalin e votës dhe rrotull tij i përket ta ruajë komisioni i votimit, i cili mund të kërkojë gjithashtu ndihmën e forcave publike.

11. Punëmarrësi që merr pjesë në votim pajiset, në lokalin e votimit, me fletën e tij të votimit, pasi ka treguar identitetin e tij, në rast se duhet, dhe pasi e ka provuar këtë identitet.

Ai shkruan në fletëvotimin e tij numrin e sindikatës, së cilës ai i jep votën.

Çdo fletëvotim që përmban më shumë se një numër, konsiderohet e pavlefshme.

12. Votimi zhvillohet në një ose disa ditë pune gjatë orëve 900-1500.

13. Pas mbylljes së votimit, komisioni i votimit bën hapjen e kutisë së votimit dhe numërimin e votave. Pas numërimit hartohet një procesverbal dhe firmoset nga kryetari i komisionit të votimit.

14. Konsiderohet si përfaqësuese sindikata apo grupi i sindikatave që fitojnë shumicën relative të votave. Me shumicë relative kuptohet numri i votave superior ndaj votave të marra nga secila prej sindikatave të tjera që marrin pjesë në të njëjtin votim.

Kur disa sindikata janë grupuar, numërohen së bashku të gjitha votat që kanë numrin që i është dhënë grupit.

15. Procesverbali përmban të dhënat e mëposhtme:

a) Numrin e punëmarrësve në njësinë e bisedimit;

b) numrin e votave të marra nga secila sindikatë apo grupim sindikate, si dhe përqindjet që përfaqësojnë këto shifra.

Procesverbali nuk mund të përmbajë asnjë emër të ndonjë punëmarrësi.

16. Shpenzimet e votimit do të jenë në ngarkim të organizatave të punëmarrësve që marrin pjesë në votim.

Kryetari i Komisionit të Votimit ka të drejtë të kërkojë parapagimin e shpenzimeve; nëse ky parapagim nuk bëhet brenda afatit të caktuar, sindikata humbet të drejtën të marrë pjesë në votim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi